



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KRYETARI I KOMUNËS SË SHTIMES



Nr. 02/640

Datë: 18. 11. 2020

Duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenin 4 dhe nenin 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Nenin 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Planin Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Kuvendi Komunës së Shtimes, mori këtë:

**PROPOZIM-VENDIM**

**PROPOZIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN  
KOMUNALE**

**I**

Kryetari i Komunës me shkresën Nr.02/640, datë: 18. 11. 2020, i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes miratimin e Vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. Pjesë nga Prona e pa luajtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00230-0; Me sipërfaqe 35231m<sup>2</sup>; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 99 vite.
2. Prona e paluajtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Ahishta për mbi shpi”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00251-0; Me sipërfaqe 3859m<sup>2</sup>; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.

**II**

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e planeve komunale si: Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Strategjia e Zhvillimit Rural, Përkrahjen e bizneseve vendore. Do të ndikojë pozitivisht në: Punësim, Investime, Shtimin e numrit të bizneseve, Rritje e numrit të taksapaguesve, Zhvillim ekonomik, dhe të hyra për Komunën.

**III**

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike (konkursit).

Kryetari i Komunës  
Nam Ismajli